

Mirë se vini në Rajonin Jämtland Härjedalen!

Informacion për ty që je i ri në Suedi dhe Jämtland e Härjedalen dhe ke nevojë të vish në kontakt me organet e shëndetësisë dhe dentarisë.

www.regionjh.se
063-14 75 00

Kur vjen si azilkërkues të ofrohet një kontroll falas shëndetësor

Ky kontroll bëhet sa më shpejt pas ardhjes tuaj në Suedi. Nëse nuk ke leje apo je i fshehur po ashtu ke të drejt për kontroll shëndetësor.

Gjatë këtij kontrolli do të takohesh me një mjek apo infermier. Ju do të bisedoni për shëndetin tuaj dhe të ofrohen ca analiza gjaku për të shikuar se a ke sëmundje të rrezikshme ngjitëse. Ky kontroll bëhet për të ofruar mjekim dhe terapi nëse ke nevojë. Ti po ashtu informohesh se si funksionon sistemi shëndetësor. Ky kontroll bëhet nga Njësia e azilit dhe e shëndetit për refugjat.

Ti e merr ftesën me kohën e caktuar për kontroll përmes postës. Ti po ashtu mund të telefonosh në 06314 23 60 për të caktuar vet kohë nëse nuk ke marrë ftesë dhe nuk ke e ke bërë këtë kontrollim më herët.

E drejta për kujdes mjeksor dhe dentar

Azilkërkuesit e rritur, mbi 18 vjeç kanë të drejtë për mjekim emergjent në rast sëmundje, rasteve dentare, abort, maternitet, kujdes për lindje, këshilldhënie për mjete preventive, mjekim sipas ligjit për sëmundje ngjitëse, apo për mjekim që mjeku apo dentisti gjykon se e pengon zhvillimin e një sëmundje serioze. Taksa për vizita paguhet sipas një liste të posaçme, çmimi është më i ulët sesa për pacientë të tjerë.

Azilkërkuesit fëmijë dhe të rinjë nën 18 vjeç kanë të drejta të njëjta për shërbime falas mjeksore dhe dentare, si të gjithë të tjerët në Suedi.

Nëse ke marrë leje qëndrimi ti ke të drejtë në shërbime mjeksore dhe dentare sipas kushteve të njëjta si gjithë shtetasit suedez. Mjekimi jepet duke u bazuar në nevojën për mjekim dhe për të vendosurit në komunë sipas taksës së rregullt. Për ata që banojnë në banesat e Zyrës së Migracionit taksat janë sikur për azilkërkues nëse tregohet karta-LMA. Shërbimet mjeksore janë falas deri sa fëmija të mbush 18 vjeç. Shërbimet dentare janë falas deri në moshën 21 vjeçare, e pasatj sipas taksës së rregullt të dentarisë.

Nëse ti nuk mund të vish në një vizitë të rezervuar ti duhet ta ç'regjistrosch vizitën në kohë, përndryshe duhet ta paguash taksën edhe nëse nuk ke qenë në vizitë.

Nëse ke nevojë për përkthyes

Ti ke gjithmonë të drejtë për përkthyes kur ke kontakt në organet shëndetësore dhe dentare. Është me rëndësi që të vish me kohë në vizitat në qendrën mjeksore, spital apo dentisti, sepse përkthyesi caktohet vetëm për kohën e rezervuar për vizitën tuaj.

Konfidencialiteti profesional

Personeli mjeksor dhe përkthyesit kanë konfidencialitet profesional. Kjo do të thotë se ata nuk i përcjellin të dhënat tua te ndonjë person tjetër apo institucion pa lejen tuaj.

Në rastin kur viziton organet shëndetësore, dentare apo blen ilaçe me recetë

Nëse ke mundësi, **merre gjithmonë me vete** letërnjoftim, dokument identiteti nga Zyra Tatimore, fletëazili, kartë-LMA apo pasaportë për të vërtetuar identitetin tuaj.

Nëse nuk ke numër personal suedez, atëherë ty të jepet një numër rezervë herën e parë kur i viziton organet shëndetësore në rajonin Jämtland Härjedalen. Këtë numër duhet ta ruash dhe ta kesh me vete herën tjetër kur viziton organet mjeksore. Nëse e humb numrin rezervë atëherë duhet ta thuash emrin dhe datëlindjen përsëri

Udhëtimi për vizitë në organet mjeksore

Ti vet e ke përgjegjësinë për udhëtimi për në organet shëndetësore dhe dentare. Kur udhëton për vizita mjeksore apo dentare në radhë të parë zgjedhe udhëtimin me autobusë, tren apo makinë private. Më vonë mund të kompenzohesh për një pjesë të shpenzimeve të udhëtimit. Ruaje kviton dhe kërko një formular për udhëtime shëndetësore në institucionin ku bënë vizitën.

Lexo më shumë rreth kompensimit në <http://ltr.se/fardtjanst-sjukresor/sjukresor/>

Nëse ti për arsye shëndetësore ke vështirësi të shkosh në vizitë mjeksore, atëherë në raste të caktuara mund të kesh të drejtë të udhëtosh me taksì. **Personeli mjeksor e vlerëson se kush është aq i sëmurë sa që ka nevojë të udhëtoj me taksì.** Të afërmit mund të udhëtojnë me taksin vetëm nëse personeli vlerëson se ti je aq i sëmurë sa që ke nevojë për ndihmën e të afërmit. Ti e bënë pagesën tek shoferi i taksit para se të niseni.

Ti vet e ke përgjegjësinë që të rregullosh kthimin në shtëpi me autobus, tren apo makinë private, nëse personeli nuk të thotë diçka tjetër. Kjo vlen edhe nëse ke ardhur në vizitë me taksì apo ndihmë të shpejt.

Nëse ke nevojë për këshilla shëndetësore

Nëse telefonon në numrin 1177 mund të flasësh me një infermier. Infermieri mund të përgjigjet në pyetje, jep këshilla dhe vlerëson nëse ke nevojë për mjekim dhe të ndihmonë më tutje. **Ti mund të telefonosh në 1177 në çdo kohë 24 orë në ditë.**

Nëse dëshiron që vet të kërkojsh informacion për shëndetin

Në www.1177.se ka informacione për sëmundje, ekzaminime dhe trajtime. Shumë nga informacionet janë të përkthyer në gjuhë të ndryshme.

Je i sëmurë apo ke probleme me shëndetin tuaj?

Nëse ke probleme që nuk kërkojnë mjekim në spital ti kërkon ndihmë në qendrën shëndetësore. Qendra shëndetësore punon nga ora 08.00 deri në 17.00, çdo ditë pune. Për të takuar mjek apo infermier duhet të caktosh kohë. Ka qendra shëndetësore që ofrojnë pranim të hapur brenda një kohe të caktuar në javë.

Të dhënat kontaktuese të qendrës tuaj shëndetësore/ dentare:

Nëse sëmuresh rëndë apo lëndohesh

Nëse papritmas sëmuresh rëndë apo lëndohesh në një aksident ti duhet të shkosh në repartin e emergjencës në spitalin Östersund. Reparti i emergjencës punon 24 orë, çdo ditë.

Numri i telefonit për raste serioze emergjente: 112.

112 është numër emergjent dhe lejohet të shfrytzohe vetëm në raste rreziku për jetë.

Nëse je azilkërkues dhe shtrihesh në spitalin Östersund është e rëndësishme që ti apo dikush tjetër ta lajmëroj Zyrën e Migracionit në Östersund. Numri i telefonit të Zyrës së Migracionit është 010-485 54 18.

Nëse ke dhimbje në dhëmbë

Ti që ke nevojë për ndihmë emergjente dentare (nëse ke temperaturë, ënjtur, dhimbje apo ke pësuar goditje në gojë), duhet të telefonosh në numrin kujdestar të shërbimit dentar 063-15 33 00. Për të takuar dentist apo infermier dhëmbësh duhet të caktosh kohë.

Nëse ke nevojë të flasësh me dikë

Në raste të problemeve të lehta psikike ti e kontakton qendrën shëndetësore apo njësinë për shëndetin e azilkërkuesve- refugjatëve. Mund të bhet fajë për çrregullime gjumi, ankth apo reaksione tjera krize dhe mërzie.

Nëse ndjehesh keq psikikisht dhe ke nevojë për **ndihmë menjëherë** ti mund ta kontaktosh repartin emergjent të psikiatrisë në spitalin Östersund. Numri i telefonit: 063-15 32 50

Ti mund të telefonosh edhe në 1177 i cili të ndihmonë për kontakt.

Nëse je apo do ngelësh shatatzënë

Testi i shtatzënisë mund të blihet në farmaci dhe shumë dyqane. Kontaktoje qendrën tuaj shëndetësore posa të kuptosh se je shtatzënë. Në qendrën shëndetësore ka ordianca të mamisë/maternitetit. Ke të drejtë në kontrolle të rregullta tek një mami. Nëse ka nevojë mund të kontaktosh edhe mjek. Ty të jepet informacion për gjëra para lindjes, kujdesin gjatë lindjes dhe për kontrollin tuaj dhe të fëmijut pas lindjes. Ti mund të informohesh edhe për mjete preventive. Për këtë lloj kujdesi nuk ke nevojë të paguash asnjë taks.

Aborti

Sipas ligjit suedez femra vet vendos nëse do të bëjë abort apo jo. Ti mund ta kontaktosh qendrën shëndetësore, ose telefono 1177 i cili të ndihmonë më tutje.

Femrat që duan të këshillohen rreth abortit mund të caktojnë kohë në Ordinancën e Abortit në spitalin Östersund. Koha caktohet tek këshilltarja në Klinikën gjinekologjike, numri i telefonit 063-15 39 30 ose 063-15 35 93.

Qendra shëndetësore për fëmijë

Në qendrën shëndetësore për fëmijë, bvc, fëmijëve nga mosha 0-5 vjeç u ofrohen vizita të rregullta për kontrollime dhe vaksinime. Aty përcjelljet shëndeti dhe zhvillimi i fëmijës. Ty si prind të jepet ndihmë dhe mbështetje. Shkuarja në bvc është falas dhe vullnetare. Të gjithë fëmijët që shkojnë në bvc u caktonen vizita në bazë të moshës specifike. Nëse ti si prind ke pyetje rreth rolit tënd si prind mund ta kontaktosh bvc-n kur të duash.

Ilaçe

Ti si azilkërkues mund ta blesh një ilaç me recetë me çmim më të ulët. Ndërsa për ilaçet ku nuk kërkohet recetë e paguan çmimin e plotë.

Mbrojtje nga shpenzimet e larta

Për ty që ke leje qëndrimi ka mbrojtje nga shpenzimet e larta, si për udhëtime spitalore, ashtu edhe për shpenzime mjeksore dhe ilaçe.

Azilkërkeusit mund të aplikojnë për mjete shtesë financiare tek Zyra e Migracionit për shpenzime që nuk mbulohen në mënyra tjera. Ruaj të gjitha kvitot nga vizitat mjeksore dhe dentare, kur blen ilaçe apo udhëton për në organet shëndetësore. Zyra e Migarcionit mund të informojë më shumë për këtë.